



UNIVERSITETI I PRIZRENIT

UNIVERSITY OF PRIZREN

**„Ukshin Hoti“
Rektorati**

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. i ref.

Prizren, më 25. 03. 2016

Mbështetur në Udhëzimin Administrativ të MASHT-it nr. 24/2012 e në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të UPZ-së, të datës 23.03. 2016, Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, shpall:

K O N K U R S

Për lirimin nga pagesa e semestrit për studentët e Universitetit të Prizrenit për vitin akademik 2015/2016

Të drejt lirimi nga pagesa e semestrit për vitin akademik 2015/2016 në UPZ kanë:

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale;
2. Studentët, të cilët janë invalidë të luftës (qofshin ata ushtarakë apo civilë);
3. Studentët, që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës (gjatë periudhës 01.01.1998 -12.06.1999) dhe fëmijët e Invalidëve të UÇK-së;
4. Studentët me aftësi të kufizuara fizike;
5. Studentët e të njëjtit prind i cili ka tre (3) e me shumë studentë të rregullt në studime në Universitetet publike të Kosovës.

Të gjithë studentët duhet t'i paraqesin:

- Kërkesën për lirimin nga pagesa e semestrit dhe
- Vërtetimin e studimeve për vitin akademik 2015 - 2016

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale, i paraqesin edhe:

- a. Kopjen e vërtetuar të vendimit të ndihmës sociale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ;
- b. Vërtetimin e Qendrës për Punë Sociale për familjen dhe studentin (forma shkarkohet web-faqja ose merret në QPS në Komunë);
- c. Kopjen e letërnjoftimit të bartësit të ndihmës sociale;
- d. Kopjen e letërnjoftimit të studentit/ës;
- e. Certifikatën e lindjes së studentit/ës.

2. Studentët që janë invalid të luftës (ushtarakë apo civilë) i paraqesin edhe:

- a. Kopjen e vërtetuar të vendimit të pensionit për invalid të luftës apo invalid civil të luftës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose nga komuna përkatëse;
 - b. Kopjen e letërnjoftimit të studentit /ës invalid.
- 3. Studentët që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës dhe invalidëve të UÇK-së, i paraqesin edhe:**
- a. Kopjen e vërtetuar të vendimit për njohjen e statusit të familjes së dëshmorit, viktimës civile dhe invalidëve të UÇK-së, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose nga komuna përkatëse;
 - b. Kopjen e letërnjoftimit të bartësit të statusit të familjes së dëshmorit/viktimës civile;
 - c. Kopjen e letërnjoftimit të studentit/ës;
 - d. Certifikatën e lindjes së studentit/ës.
- 4. Studentët me aftësi të kufizuara fizike i paraqesin edhe:**
- a. Kopjen e vërtetuar të vendimit për njohjen e statusit person me aftësi të kufizuara fizike nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose nga shoqatat e licencuara të personave me aftësi të kufizuara;
 - b. Kopjen e letërnjoftimit të studentit/ës.
- 5. Njëri nga tre ose më shumë student e së njëjtës familje të ngushtë që studiojnë në Universitetet publike i paraqesin:**
- a) Certifikatën e lindjes së studentëve;
 - b) Vërtetimet e të gjithë studentëve për regjistrimin në vitin akademik 2015/2016.

Dokumentet e kompletuar duhet të dorëzohen në Zyrën nr. 308

Kërkesat dhe dokumentacioni i pranuar zyrtarisht nga zyra nr. 308 i dorëzohet Komisionit për lirim në Rektoratin e Universitetit të Prizrenit.

Me rastin e paraqitjes për lirim nga pagesa e semestrit, studentët duhet t'i sjellin vetëm dokumentet origjinale.

Afati për konkurrim është prej datës 25.03.2016 e deri më 08.04.2016

Format e nevojshme për konkurrim gjenden në web-faqen e Universitetit të Prizren

www.uni-prizren.com dhe në Zyrën nr. 308